

E ENJTE DATA 2 MARS 2023

20 shkurt 2023, ora 14:20. Kronika thotë se Sali Berisha zhvillon një mbledhje me drejtuesit politikë të qarqeve të foltores dhe në fjalën e tij thotë këtë fjali: “Nëse njeri mendon se Edi Rama mund të ikë me votë, personalisht nuk e mendoj se ai mund të ikë me votë; çdo ditë tregon se shtetin e tij po e shndërron gjithmonë e më shumë në një makineri votash.”. Në këtë foto janë disa nga drejtuesit politikë të Partisë Demokratike ose të foltores, se nuk dua të hyj në debat, të cilët duhet të dalin me njerëz dhe të mbledhin vota për foltoren. Por unë them se kjo fjali është thelbi i asaj që ju keni një muaj që doni ta krijoni në parlament, kjo fjali është thelbi i asaj që doni të krijoni sot në këtë debat, pikërisht bindja e plotë se nuk fitoni dot më 14 maj. Dhe nuk është 14 maji shumë larg, është vetëm 80 ditë nga dita kur Sali Berisha shprehet “Edi Ramën nuk e mundim dot me votë”. Po si mund ta mundni? Me çfarë mund ta mundni? Si mund ta rrëzoni Partinë Socialiste nga mbështetja popullore? Me revolucion, këtë thatë, e nderuar Jorida, edhe në vitin 2016, e thatë në vitin 2017. Një guggëllim i thjeshtë tregon se ish-drejtuesi juaj në shumë deklarata ka thënë po të njëjtën fjali: “Edi Rama nuk mund të rrëzohet me votë!”. “Vendimi është marrë, është një vendim popullor, i pakthyesëm, - thoshte zoti Basha. - Zgjedhjet e lira dhe të ndershme mund të bëhen vetëm pa Edi Ramën.” E thatë në vitin 2017, e dini se si dolën; e thatë në vitin 2019, krijuat një hipotezë shumë të madhe se nuk do të paraqiteshit në zgjedhje fare, dhe e shikoni ku jemi. E thatë në vitin 2021 prapë. A e kuptoni ku jeni? E thoni sot, vetëm 80 ditë para zgjedhjeve, kur drejtuesit tuaj duhet të ishin duke organizuar strukturat, duhet të paraqisnin programet, lidershipin e tyre nëpër rrethe, duhet të kërkonin votën për Partinë Demokratike. Por bindja që nuk fitoni, ju bën të jeni kaq pak edhe në këtë sallë, pas kaq ditësh që kërkonit debat. Edhe princi juaj i kaltër, që do të marrë Tiranën, mungon në debat. Edhe pse është deputet, nuk ka as kurajën të vijë e të thotë këtu pse do ta marrë Tiranën dhe për çfarë. Po të tjerët, që janë në rrethe? Si do t’i fitoni pa votë Vlorën, Shkodrën, Tiranën, Durrësin, Sarandën, Kukësin, Tropojën? Asgjë nuk do të fitoni. E keni këtë bindje, prandaj jeni edhe këtu, në këtë debat. E keni këtë bindje, të krijuar tashmë edhe prej shumë vitesh në opozitë dhe nuk po gjeni dot të vërtetën e madhe: vetëm me votë mund të vini në pushtet, vetëm vota është ajo që ndan partitë tona politike.

Keni kaq ditë që kërkonit të hidhni baltë mbi marrëdhëniet e kësaj mazhorance, të këtij shteti, me aleatin më të madh euroatlantik. E dini shumë mirë se vetëm me atë aleat, nuk ka shumë shanse të luhet. Sot Sali Berisha tha se e gjithë kjo histori, që doni ta ngrini, është një histori e raportit të disa njerëzve, agjentëve të fshehtë ose jo të fshehtë, publikë ose jopublikë, me non grata-n. Po i vetmi non grata në këtë sallë është Sali Berisha. Të tregonte ai nëse Duçka me Nezën apo agjenti i FBI-së i kanë vajtur dhe i kanë kërkuar lekë, sepse atë kemi dëshmitar, sepse tjetër nuk kemi non grata. A i kanë vajtur ata dhe i kanë kërkuar lekë Saliut për ta hequr non grata-n? Dje patëm deklaratën zyrtare të Gabriel Escobar-it, Zëvendësndihmës/Sekretarit të Shtetit për Europën dhe Euroazinë, i cili tha: “Do të them se, nga perspektiva e DASH-it dhe qeverisë amerikane, Shqipëria është një aleate solide në NATO, një partnere e mirë bilaterale, ka qenë një ndihmëse e madhe për ne në Këshillin e Sigurimit. Nuk ka asnjë ndikim në marrëdhëniet tona bilaterale midis SHBA-ve dhe Shqipërisë”. Këtë e thotë përfaqësuesi më i lartë që mund të flasë nga DASH-i. Ndërkohë që, sot përsëri, kolegë, nuk dëgjova nga ju asnjë ndjesi për këtë marrëdhënie shumë të mirë dhe këtë aleancë të fortë që ka ky shtet. Në fakt, duhet ta kemi të Kuvendi i Shqipërisë LEGJISLATURA X - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 2 MARS 2023 56 gjithë së bashku. Nga kjo foltore dëgjova përsëri akuza për përfaqësuesit më të lartë të këtyre zyrave kaq të rëndësishme, dhe për të shkuar pastaj të thelbi i bisedës se për çfarë e kërkonit

komisionin hetimor. Për çfarë doni ta ngrini këtë akuzë pa asnjë bazë? Doni të thoni se Partia Socialiste, Edi Rama, kanë ndikuar për të çuar në zyrat amerikane atë që keni bërë ju? Ju e keni bërë. Keni paguar para, që hetimet thonë se janë nga burime ruse, por që, sido të jetë, duhet ta gjejë hetimi. Keni paguar para që në vitin 2017 që të kishit një foto me ish-Presidentin amerikan, Tramp. E morët foton, paguat 750 mijë euro, thonë debatet tuaja të brendshme. Po për çfarë ju vlejti?! Pra, kjo është historia. Zgjedhjet nuk fitohen me revolucion, i cili nuk karikon dot as drejtuesit më të lartë të revolucionit. Zgjedhjet nuk fitohen dot pa organizim, zgjedhjet nuk fitohen dot pa lidhshëm, zgjedhjet nuk fitohen dot pa paraqitur programin. Dhe për sa kohë nuk jeni të zotë të gruponi njerëzit për të shprehur alternativat, për të shprehur pse duhet të votojnë qytetarët e Shqipërisë për disa alternativa që ka tani Partia Demokratike, asnjëherë nuk keni për të fituar! Ju kemi mundur kur keni qenë bashkë, ju kemi mundur veç e veç, do t'ju mundim prapë më 14 maj dhe do t'ju mundim sa herë që nuk e kuptoni se kjo foltore dhe kjo sallë janë për të shprehur alternativa dhe jo për të shkruar skenarë të denjë për çdo film apo telenovelë, që nuk kanë lidhje me realitetin.